

V E N D I M

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i - - - - -
Veli Budo,	Anëtar i - - - - -
Zija Vuci,	Anëtar i - - - - -
Alfred Karamuço,	Anëtar i - - - - -
Franc Jakova,	Anëtar i - - - - -
Kristofor Peçi,	Anëtar i - - - - -
Halil Kopani,	Anëtar i - - - - -

me sekretare Drita Filto, më datën 14. 7. 1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.40 Akti që i përket :

KËRKUESE: PARTIA DEMOKRATIKE, e përfaqësuar nga Z. Pelha...h C...lo.

SUBJEKT I INTERESUAR :KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, i përfaqësuar nga sekretari, Z. Thimjo Kondi.

O B J E K T I

Shfuqizimi i Vendimit datë 10. 7.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili ka lënë në fuqi vendimin e komisionit të zgjedhjeve të zonës elektorale nr.4, lidhur me rezultatet përfundimtare të votimit në turin e dytë të 6 korrikut 1997.

GJYKATA KUSHTETUESE pasi dëgjoji përfaqësuesit e kërkuarit dhe të subjektit të interesuar si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V E R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin datë 10. 7.1997, ka lënë në fuqi vendimin e komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.4, datë 7. 7.1997, sipas të cilit është shpallur fitues kandidati i Partisë Socialiste.

Ankuesi i është drejtuar kësaj Gjykate, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të mësipërme për shkak se zgjedhjet e raundit të dytë, në këtë zonë janë zhvilluar në kundërshtim të hapur dhe flagrant me dispozitat e Ligjit "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", për arsye se, veç parregullsive të shumta, në 14 qendra votimi, nuk janë zhvilluar votime më datë 6. 7.1997, për shkak të mosshpërndarjes së materialeve të votimit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetuan pretendimet e kërkuarit se nga nga 58 qendra votimi të zonës së zgjedhjeve nr.4, në 14 prej tyre dhe konkretisht në ato me numër 10,12,19,20,21,22,23,27,28,33,43,53,54 dhe 58, nuk janë zhvilluar votimet.

Ky fakt është njohur dhe pranuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve por, me arsyetimin se, kjo përben një parregullsi të së njëjtes natyre për të dy kandidatet dhe nuk

ndikon në rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, ka shpallur fitues kandidatin e Partisë Socialiste, i cili ka marrë 129 vota më shumë se kandidati i Partisë Demokratike.

Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se moszhvillimi i zgjedhjeve në 14 qendra votimi të zonës nr.4, për shkak të faktoreve të paligjshëm që penguan votimin nuk është shprehur një parregullsi, por përben një cënim të rëndë të së drejtës së përgjithshme të shtetasve për të marrë pjesë në zgjedhje. E drejta e zgjedhjeve përfaqëson një nga të drejtat themelore në të rëndësishme kushtetuese të shtetasve në fushën e veprimtarisë së tyre politike dhe çdo mohim apo cënim i kësaj të drejte është antikushtetues, prandaj vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.4 duhet të shfuqizohet.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon se në 14 qendrat e votimit të sipërpërmendura të zonës së zgjedhjeve nr.4 duhet të zhvillohen zgjedhjet e raundit të dytë dhe rezultatet e votimit në këto qendra votimi duhet t'i bashkohen rezultateve të nxjerra të 44 qendrave të tjera të votimit.

Duke u nisur nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e Partisë Demokratike është e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24, pika 7 të Ligjit nr.7561, datë 29. 4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29. 4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", si dhe nenit 50 të Ligjit nr.7556, datë 4. 2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit datë 10. 7.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të vendimit datë 7. 7.1997 të komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.4.

Urdhërohet zhvillimi i zgjedhjeve të raundit të dytë në qendrat e votimit nr.10,12,19,20,21,22,23,27,28,33,43,53,54 dhe 58 të zonës së zgjedhjeve nr.4.

Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Komisionit të Mandateve të Kuvendit të Ri Popullor.

Tiranë, më 21. 7.1997

Nr. 40 i regjistrit themeltar.

Nr. 32 i vendimit.